



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova  
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

## KUVENDI I KOMUNËS KOMITETI PËR POLITIKË DHE FINANCA

**KONSTATIME të Komitetit për Politikë dhe Financa, të rekomanduara për mbledhjen e Kuvendit të Komunës e caktuar të mbahet më 29 korrik 2024**

*Fillimisht në propozim të z.Fatlum Osmani, drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave, dhe i Autorizuar për ushtrimin e funksionit të drejtorit të Drejtorisë së Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë, me 5 vota Për, asnjë votë Kundër dhe asnjë votë e Përmbajtur (të tjerët nuk votuan), mbështetet që rendi i ditës të plotësohet edhe me dy pika shtesë, dhe atë:*

- *Propozim vendimi për shpalljen në interes të përgjithshëm publik, pronat nën menaxhimin e AKP-së, me qëllim të realizmit të projekteve: Muzeu i Qytetit; Ndërtimi i banimit me kosto të përballeshme; Objekt arsimor - Çerdhe; Ndërtimi i parkut.*
- *Propozim vendimi për transferin e buxhetit të Komunës për vitin 2024.*

**- Propozim vendimi për shtim të buxhetit dhe kod të ri-projekti “Furnizim me mekanizëm bujqësor”**  
*Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit / KPF-së konstatoi se Njëzëri me 5 vota Për, nga anëtarët e KPF-së sa ishin prezent në sallë, kjo pikë e rendit të ditës rekomandohet për shqyrtim në mbledhjen e Kuvendit, sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e mbledhjes.*

**- Propozim vendimi për shtim të buxhetit dhe kod të ri - projekti “Furnizim me mëshqerra”**  
*Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit / KPF-së konstatoi se nga 5 anëtar sa ishin prezent në sallë, me 4 vota Për, 1 votë Kundër, asnjë votë e Përmbajtur, kjo pikë e rendit të ditës rekomandohet për shqyrtim në mbledhjen e Kuvendit, sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e mbledhjes.*

**- Propozim vendimi për shtim të buxhetit dhe kod të ri - projekti “Furnizim me sera”**  
*Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit / KPF-së konstatoi se nga 5 anëtar sa ishin prezent në sallë, me 4 vota Për, 1 votë Kundër, asnjë votë e Përmbajtur, kjo pikë e rendit të ditës rekomandohet për shqyrtim në mbledhjen e Kuvendit, sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e mbledhjes.*

**- Propozim vendimi për shpalljen në interes të përgjithshëm publik pronat e paluajtshme shoqërore “Mekanizmi” nën menaxhimin e AKP-së, dhe atë: Njësitë kadastrale 00244-2 dhe 00244-3 në Zonën Kadastrale Podujevë, për realizmin e projektit “Ndërtimi i objektit për Banim të Përballeshëm”.**

*Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit / KPF-së konstatoi se Njëzëri me 5 vota Për, nga anëtarët e KPF-së sa ishin prezent në sallë, kjo pikë e rendit të ditës rekomandohet për shqyrtim në mbledhjen e Kuvendit, sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e mbledhjes.*

**- Propozim vendimi për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës, Ndërmarrjes Publike Lokale “Eko-Llapi” Sh.A. në Podujevë**

*Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit / KPF-së konstatoi se nga 5 anëtar sa ishin prezent në sallë, me 4 vota Për, asnjë votë Kundër, 1 votë të Përmbajtur, kjo pikë e rendit të ditës rekomandohet për shqyrtim në mbledhjen e Kuvendit, sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e mbledhjes.*

**- Raporti Financiar për periudhën janar - qershor 2024**

*Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit / KPF-së konstatoi se Njëzëri me 5 vota Për, nga anëtarët e KPF-së sa ishin prezent në sallë, kjo pikë e rendit të ditës rekomandohet për diskutim në mbledhjen e Kuvendit, sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e mbledhjes.*

**- Raporti i Auditimit për pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Podujevës për vitin 2023**

**- Plani i Veprimit për zbatimin e rekomandimeve nga Raporti i Zyrës Kombëtare të Auditimit**

*Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit / KPF-së konstatoi se Njëzëri me 5 vota Për, nga anëtarët e KPF-së sa ishin prezent në sallë, kjo pikë e rendit të ditës rekomandohet për diskutim në mbledhjen e Kuvendit, sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e mbledhjes.*

**- Propozim vendimi për shfuqizimin e vendimit nr.prot.01-016/01-0045377/23 për miratimin e Planit të Integritetit 2023-2027 në Komunën e Podujevës**

*Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit / KPF-së konstatoi se Njëzëri me 5 vota Për, nga anëtarët e KPF-së sa ishin prezent në sallë, kjo pikë e rendit të ditës rekomandohet për shqyrtim në mbledhjen e Kuvendit, sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e mbledhjes.*

**- Propozim vendimi për iniciimin e procedurave për hartimin e planit rregullues të hollësishëm në pjesën e poshtme të qendrës 2 lindje - blloku 1**

*Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit / KPF-së konstatoi se nga 5 anëtar sa ishin prezent në sallë, me 4 vota Për, asnjë votë Kundër, 1 votë të Përmbajtur, kjo pikë e rendit të ditës rekomandohet për shqyrtim në mbledhjen e Kuvendit, sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e mbledhjes.*

*Pas paraqitjes së fjalës hyrës dhe diskutimeve për pikat e rendit të ditës të renditura nga 11 deri në 20, Kryesuesi i Kuvendit / KPF-së i hedhi në votim që t'i rekomandohen Kuvendit për shqyrtim në mbledhjen e radhës së Kuvendit, sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e mbledhjes, dhe atë për pikat e rendit të ditës nga 11 deri në 20, si në vijim.*

- **Propozim vendimi për miratim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës - Njësia kadastrale P-163-0, ZK Siboc i Epërm**  
*-Propozim Vendimi për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim*
- **Propozim vendimi për miratim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës - Njësia kadastrale P-297-0, ZK Dobratin**  
*-Propozim Vendimi për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim*
- **Propozim vendimi për miratim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës - Njësia kadastrale P-337-1, ZK Dobratin**  
*-Propozim Vendimi për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim*
- **Propozim vendimi për miratim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës - Njësia kadastrale P-337-2, ZK Dobratin**  
*-Propozim Vendimi për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim*
- **Propozim vendimi për miratim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës - Njësia kadastrale P-336-0, ZK Dobratin**  
*-Propozim Vendimi për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim*
- **Propozim vendimi për miratim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës - Njësia kadastrale P-640-0, ZK Lupç i Poshtëm**  
*-Propozim Vendimi për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim*
- **Propozim vendimi për miratim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës - Njësia kadastrale P-1392-0, ZK Dobërdol**  
*-Propozim Vendimi për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim*
- **Propozim vendimi për miratim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës - Njësia kadastrale P-1378-0, ZK Dobërdol**  
*-Propozim Vendimi për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim*
- **Propozim vendimi për miratim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës - Njësia kadastrale P-1381-1, ZK Dobërdol**  
*-Propozim Vendimi për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim*
- **Propozim vendimi për miratim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës - Njësia kadastrale P-1381-2, ZK Dobërdol**  
*-Propozim Vendimi për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim*

*Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit / KPF-së konstatoi se Njëzëri me 5 vota Për, nga anëtarët e KPF-së sa ishin prezent në sallë, pikat renditura nga 11 deri në 20 sipas rendit të ditës, rekomandohen për shqyrtim në mbledhjen e Kuvendit, sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e mbledhjes.*

- Propozim vendimi për shpalljen në interes të përgjithshëm publik, pronat nën menaxhimin e AKP-së, me qëllim të realizimit të projekteve: Muzeu i Qytetit; Ndërtimi i banimit me kosto të përballueshme; Objekt arsimor – Çerdhe; Ndërtimi i parkut.

*Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit / KPF-së konstatoi se Njësëri me 5 vota Për, nga anëtarët e KPF-së sa ishin prezent në sallë, kjo pikë e rendit të ditës rekomandohet për përfshirje në kuadër të rendit të ditës dhe shqyrtimin e të njëjtës në mbledhjen e Kuvendit të Komunës, sipas materialit përkatës të prezantuar në këtë mbledhje - bashkëngjitur konstatimeve (me renditje në pikën 21 të rendit të ditës).*

- Propozim vendimi për transferin e buxhetit të Komunës për vitin 2024.

*Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit / KPF-së konstatoi se Njësëri me 5 vota Për, nga anëtarët e KPF-së sa ishin prezent në sallë, kjo pikë e rendit të ditës rekomandohet për përfshirje në kuadër të rendit të ditës dhe shqyrtimin e të njëjtës në mbledhjen e Kuvendit të Komunës, sipas materialit përkatës të prezantuar në këtë mbledhje - bashkëngjitur konstatimeve, (me renditje në pikën 22 të rendit të ditës).*

Nr. Prot. 01-052/09-0049263/24  
Podujevë, datë: 29 korrik 2024



Kryesuesi i Kuvendit  
Hilmi Hoxha



**Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova**  
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

## **KRYETARI I KOMUNËS**

Në bazë të nenit 58 shkronja h) ndërlidhur me nenet 11; 12 paragrafët 1 dhe 2; 14 dhe 17 shkronjat c) dhe s) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, nenit 27 (me theks paragrafët 1 dhe 2) të Ligjit nr.06/L-092 për Dhënin e Shfrytëzimit dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, ndërlidhur me nenet 34 dhe 35 të Rregullores (QRK) nr.09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzimit dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës dhe nenit 61 paragrafi 1.8, ndërlidhur me nenet 11; 15 paragrafët 1 dhe 2; dhe 19 paragrafët 1.3; 1.19 të Statutit të Komunës së Podujevës nr.prot.01-020/01-0050862/18, Kuvendit të Komunës së Podujevës, i

### **PROPOZOHET**

#### **VENDIM**

#### **PËR SHPALLJEN NË INTERES TË PËRGJITHSHËM PUBLIK**

##### **Neni 1**

1. Me këtë Vendim shpallen në interes të përgjithshëm publik pronat e paluajtshme të cekura si në vijim:

**1.1.** Prona/t e paluajtshme në sipërfaqe të përgjithshme 188 m<sup>2</sup>, sipas certifikatës pronësore nr.08-942/06-0047046/24 të datës 19.07.2024, Njësitë kadastrale nr: O-71712062-02871-0-40-0 në Zonën Kadastrale Podujevë, të evidentuara si Ndertesë Administrative N.SH.Llapi të cilat janë nën menaxhimin e Agjencionit Kosovar të Privatizimit.

Qëllimi i shpalljes në interes të përgjithshëm publik të kësaj / këtyre pronave është për realizimin e projektit **“Muzeu i qytetit”**.

**1.2.** Prona/t e paluajtshme në sipërfaqe të përgjithshme 3000 m<sup>2</sup>, sipas certifikatës pronësore nr. 942/06-0047046/24 të datës 19.07.2024 Njësitë kadastrale nr: P-71712062-02154-1 në Zonën Kadastrale Podujevë, të evidentuara si Pronë Shoqërore Ina Zagreb Dega Prishtinë, të cilat janë nën menaxhimin e Agjencionit Kosovar të Privatizimit.

Qëllimi i shpalljes në interes të përgjithshëm publik të kësaj / këtyre pronave është për realizimin e projektit **“Ndërtimi i banimit me kosto të përballeshme”**.

**1.3.** Prona/t e paluajtshme në sipërfaqe të përgjithshme 4874 m<sup>2</sup>, sipas certifikatës pronësore nr. 942/06-0047046/24 të datës 19.07.2024 Njësitë kadastrale nr: P-71712062-01025-2 në Zonën Kadastrale Podujevë, të evidentuara si Pronë shoqërore Kooperativa Bujqësore, të cilat janë nën menaxhimin e Agjencionit Kosovar të Privatizimit.

Qëllimi i shpalljes në interes të përgjithshëm publik të kësaj / këtyre pronave është për realizimin e projektit **“Objekt Arsimor- Çerdhe”**.

**1.4. Prona/t e paluajtshme Objekt i cili gjendet ne Njësitë kadastrale nr: P-71712062-00331-0 në Zonën Kadastrale Podujevë sipas certifikatës pronësore nr. 942/06-0047046/24 të datës 19.07.2024, Objekti evidentohet si Pronë Shoqërore Lokali i Ramiz Sadikut , të cilat janë nën menaxhimin e Agjencionit Kosovar të Privatizimit.**

**Qëllimi i shpalljes në interes të përgjithshëm publik të kësaj / këtyre pronave është për realizimin e projektit "Ndërtimi i Parkut".**

#### **Neni 2**

Autorizohet Kryetari i Komunës që konform dispozitave ligjore në fuqi të ndërmerr të gjitha veprimet e nevojshme për zbatimin e këtij vendimi.

#### **Neni 3**

Për zbatimin e procedurave përkatëse ligjore lidhur me rregullimin e dokumentacionit teknik, regjistrimin e pronës në librin kadastral si dhe çështje e veprime tjera të nevojshme obligohet Drejtoria e Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë.

#### **Neni 4**

Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Kryetari i Komunës dhe Drejtoria e Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë.

#### **Neni 5**

Pas shqyrtimit dhe miratimit, ky Vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe 7 ditë pas publikimit në ueb faqen zyrtare të Komunës, përkatësisht konform nenit 81 të ligjit për vetëqeverisje lokale nr.03/L-040, dhe Rregullores (QRK) nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave, me plotësim ndryshimet e bëra me Rregulloren nr.06/2021.

Nr.Prot. 02-016/01-0049056/21  
Podujevë, datë: 29.07.2024





**Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova**  
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

## **KRYETARI I KOMUNËS**

Në bazë të neneve 12.2 shkronja d), 40.2 shkronja c), dhe 58 shkronjat b), h), të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, neneve 2 dhe 4 të Ligjit për financat e pushtetit lokal nr.03/L-049, nenit 30.1 të Ligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë nr.03/L-048, nenit 16 paragrafi 1 të Ligjit nr.08/L-260 mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2024, dhe nenet 15 paragrafi 2.4, nenit 34 paragrafi 2.3 dhe 61 paragrafi 1.8, të Statutit të Komunës, nr.01-020/01-0050862/18 të datës 29 qershor 2018, Kryetari i Komunës, Kuvendit të Komunës së Podujevës, i

### **PROPOZON**

## **VENDIM PËR TRANSFERIN E BUXHETIT TË KOMUNËS PËR VITIN 2024**

### **Neni 1**

1. Transferohen mjetet nga granti qeveritar - 10, për Investime Kapitale – 30, si vijon;

#### **1.1. Nga programi 94320 – Arsimi i Mesëm, kodi funksional - 0922, Fondi burimor - 10, kategoria ekonomike Investime kapitale, kodi - 30:**

- Ndërtimi i një objekti të shkollës së mesme te kampusi i shkollave të mesme – kodi 51920  
.....225,000.00€

**Totali.....225,000.00 €**

#### **Transferohen në:**

#### **Programin e Arsimit- nënprogrami -93120 - Arsimi fillor, për investime kapitale, kodi 30**

- Ndërtimi i shkollës fillore në fshatin Shajkofc-kodi 54258.....150,000.00€  
- Renovimi i objekteve shkollore: SHML “Isa Boletini”, SHFMU “Dëshmoret e Kombit”, SHFMU “Hamit Sejdiu” dhe SHFMU “Afrimi e Fahriu - kodi 54720.....75,000.00€

**Totali..... 225,000.00 €**

## Neni 2

Transferi i mjeteve buxhetore sipas këtij vendimi kërkohet nga kategoria ekonomike Investime Kapitale, kodi-30, për arsye se në një projekt nuk kemi nevojë në këtë vit për shumën e buxhetit të planifikuar e në disa projekte kemi nevojë për shtim të buxhetit në këtë vit.

## Neni 3

Vendimi hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës.

Nr.Prot. 02-401/01-0049013/24  
Podujevë, datë: 29.07.2024

